



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME / SPECIJALNA KOMORA VRHOVNOG SUDA / SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT
Rruga Nazim Gafurri 31, 10000 Prishtinë, Kosovë / Ulica Nazim Gafurri 31, 10000 Priština, Kosovo / Nazim Gafurri 31, 10000 Prishtina, KosovoVËRTETIMI MBI DORËZIMIN E
DOKUMENTIT

Duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-033 për
Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të
Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë
Kosovare të Privatizimit, pala e nënshkruar
më poshtë vërteton pranimin e dokumentit:

POTVRDA O DOSTAVI
DOKUMENTA

Na osnovu Zakona br. 04/L-033 o
Specijalnoj komori Vrhovnog suda Kosova
za pitanja koja se odnose na Kosovsku
agenciju za privatizaciju, dole potpisana
stranka potvrđuje dostavu dokumenta
navedenog dole:

Numeri i lëndës: Broj predmeta: Case Number:

C-V.-15-0002

ACKNOWLEDGEMENT OF
RECEIPT OF A DOCUMENT

Pursuant to Law no 04/L-033 on Special
Chamber of the Supreme Court of Kosovo
on Privatization Agency of Kosovo Related
Matters, the below signed party
acknowledges receipt of the document
described below:

Data e regjistrimit: Datum registrovanja: Date registered:

23/02/2014

Paditës
Tužilac
ClaimantI paditur
Tuženi
RespondentPërfaqësues
Punomoćnik
RepresentativePërfaqësues
Punomoćnik
Representative

ALB

#	Titulli i Dokumentit:	Naziv dokumenta:	Document Name:	Data Datum Dated
1	Aktvendim nga Dhoma	Rešenje komore	Decision of the Chamber	23/02/2015

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU	
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO	
Nr.	11
Br.	1125
No.	
Nr. i Fq.	7
Br. St.	
No. Fq.	
Data:	24.02.15
Datum:	
Dati:	
Prishtinë / Priština	

Pala: Stranka: Party: 1. Agjencia Kosovare e Privatizimit

Authority • Privatization • Ilir Koriusevci 8, Prishtinë

Pranuar nga: Primio: Received by: _____

Titulli: Zvanje: Title: _____

Data: Datum: Date: 24 FEB 2015

Nënshkrimi Potpis: Signature: _____

Në bazë të nenit 25.8 të Shtojcës së Ligjit nr.
04/L-033, të gjitha parashtrësit dhe
dokumentet mbështetëse duhet të paraqiten
ose në gjuhën shqipe ose në gjuhën serbe dhe
të shoqërohen edhe me përkthimin në gjuhën
angleze.

Na osnovu člana 25.8 Dodatka Zakona
br. 04/L-033, svi podnesci i prateći dokumenti
moraju da budu podneseni na albanskom ili
srpskom jeziku zajedno s prevodom na engleski
jezik.

Pursuant to Section 25.8 of the Annex of the
Law no 04/L-033, all pleadings and supporting
documents must be submitted either in
Albanian or in Serbian accompanied by an
English translation.

VK C-V.-

Document Number: C-V.-15-0002-05

Page 1 of 1

DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË
LIDHEN ME AGJENSINË
KOSOVARE TË
PRIVATIZIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE
SUPREME COURT OF
KOSOVO ON PRIVATIZATION
AGENCY OF KOSOVO
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODNOSE NA
KOSOVSKU AGENCIJU ZA
PRIVATIZACIJU

C-V-15-0002

Parashtruesi

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), duke vepruar në cilësinë e administratorit të Ndërmarrjeve në pronësi Shoqërore "Trepça" nën administrimin e AKP

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Specializuar, i përbërë nga Hysen Gashi, gjyqtar kryesues, Vladimir Kanev, Gjyqtar i EULEX dhe Teuta Ibrahim, gjyqtare, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 shkurt 2015 lëshon këtë:

AKTVENDIM

1. APROVOHET në tërësi, kërkesa e AKP-së e parashtruar në cilësinë e Administratorit të "Ndërmarrjeve Trepça në Riorganizim" për zgjatjen e afatit ligjor për dorëzimin e Planit të Riorganizimit. Afati i ri është 01 nëntor 2016.
2. AKP këshillohet që menjëherë ta njoftojë Kuvendin e Kosovës për nevojën e caktimit të anëtarëve të Bordit të drejtorëve të Agjencisë.
3. AKP këshillohet që t'i lajmërojë menjëherë autoritetet e Kosovës për nevojën e mjeteve financiare për angazhimin e Ofruesit të Shërbimeve Profesionale në procedurën e riorganizimit të Trepçës.
4. AKP këshillohet të parashtojë pranë Dhomës së Posaçme raportet lidhur me rrjedhën e Riorganizimit çdo tre muaj.
5. AKP këshillohet të shpall këtë aktvendim në ueb-faqen e saj zyrtare.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri Nr. 05 L-08 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, nr. 04/L-0035 (në tekstin e mëposhtëm: Ligjit mbi Riorganizimin), bazuar në nenin 2 të këtij ligji dhe duke vepruar në pajtim me nenin 7.1 të këtij ligji, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e

mëposhtëm AKP) në cilësinë e administratorit të NSH "Trepça", në lidhje me nenin 2 të Ligjit Nr 05/L-08, dhe nenet 42.1, 42.2, 42.3, 42.4 dhe 42.5 të Ligjit mbi Riorganizimin, AKP-ja më 30 janar 2015 ka dorëzuar në Dhomën e Posaçme një kërkesë ku kërkohet nga Dhoma e Posaçme të zgjasë afatin për dorëzimin e planit të riorganizimit për NSH "Trepça". Kërkesa konsiston në aprovimin për zgjatje maksimale të afatit prej 36 muajsh që do të thotë deri më 1 nëntor 2016.

Kërkesa/propozimi për zgjatjen e afatit për dorëzimin e planit të riorganizimit të propozuar sipas administratorit është e bazuar, sepse bazohet në interesin e përgjithshëm të ndërmarrjes "Trepça" dhe në përputhje me mandatin e administratorit për të ruajtur dhe rritur vlerën e ndërmarrjes.

Përmes kësaj kërkesë Administratori gjithashtu kishte informuar gjykatën se Bordi i Drejtorëve të AKP-së nuk është i kompletuar me të gjithë anëtarët siç parashihet me Ligjin e AKP-së dhe se për momentin, Bordi i Drejtorëve të AKP-ja ka vetëm tre anëtarë, mandati i të cilëve është deri më 20 shkurt 2015.

Për më tepër, kërkuesi tërheq vëmendjen në nenin 15.2.10 të Ligjit të AKP-së që parasheh autoritetin ekskluzive të Bordit të Drejtorëve në lidhje me miratimin e planeve për riorganizimin apo ristrukturimin e ndërmarrjes. Prandaj, për shkak të përbërjes jo të plotë të Bordit të Drejtorëve të AKP, mundësia e administratorit (Agjencisë) për të kryer detyrat e tyre si janë të përcaktuara sipas Ligjit të AKP-së janë shumë të kufizuara.

Përveç kësaj, AKP-ja thekson se Agjencia ka nevojë për Ofrues të Shërbimeve Profesionale për të vlerësuar asetet e ndërmarrjeve dhe kërkesat e parashtruesve, por nuk ka mjete financiare për të angazhuar një ofrues të tillë.

Duke pasur në konsideratë të gjithë ato që u përmendën më lart, në bazë të Ligjit Nr.05/L-08 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, dhe në bazë të nenit 10.10 dhe nenit 11 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, administratori i propozon kolegjit të specializuar të Dhomës së Posaçme të marrë aktvendim me të cilin miraton kërkesën e AKP-së si vijon:

Kërkesa e AKP-së (Administratorit) për zgjatjen e afatit për dorëzimin e Planit të Riorganizimit të NSH "Trepça", deri në afat maksimal siç përcaktohet me nenin 2 të Ligjit No. 05/L-08 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre aprovohet dhe

Agjencia detyrohet të publikojë këtë aktvendim në ueb-faqen e saj zyrtare, në mediat e shkruara vendore dhe në rajon, në pajtim me nenin 43 të Ligjit për Riorganizim.

Arsyetimi Ligjor

Gjykata konstaton se është bërë pak në Riorganizimin e Ndërmarrjeve Trepça qysh prej

që Agjencia e Privatizimit ka marr cilësinë e administratorit në 2011. Procedura e vetme e përfunduar vetëm është mbledhja dhe shqyrtimi sipërfaqësor i kërkesave dhe ekzekutimi i listës së plotë të pasurive të ndërmarrjeve është në vijim. Mbledhja e parë e kreditorëve nuk është mbajtur dhe nuk është caktuar kurrfarë Komisioni i kreditorëve. Në vitin 2014, tenderi për përzgjedhjen e Ofruesit të Shërbimeve Profesionale ishte anuluar. Prandaj edhe të dhënat bazike dhe resurset për përgatitjen e Planit të Riorganizim nuk kanë ndodhur.

Në fakt-shumë faktorë anësor kanë kontribuar në gjendjen aktuale - duke filluar nga ndikimet e jashtme mbi Agjencinë (shih lëndën C-V-13-0011) për shkak të mungesës së stafit dhe fondeve të pamjaftueshme. Aktualisht, Agjencia e Privatizimit nuk ka Bord të Drejtorëve pasi të gjitha mandatet janë skaduar pa asnjë qartësi se do të bëhen kur emërimet e reja. Agjencisë i duhet që edhe më tutje të gjejë fonde dhe të organizojë një tender për angazhimin e Ofruesit Profesional të Shërbimeve.

Në këto rrethana, gjykata e konsideron të përshtatshme zgjatjen e afatit për dorëzimin e Planit të Riorganizimit deri në periudhën maksimale në dispozicion. Meqë shpallja e njoftimit për afatin e fundit të kërkesave ishte shpallur me 01 nëntor 2013, tridhjetë e gjashtë muaj skadojnë me 01 nëntor 2016. Me qëllim që gjykata të mbajë kontroll mbi procedurat Agjencia duhet të parashtojë raportet lidhur me gjendjen e tanishme të punëve në çdo tre muaj.

Këshilla ligjore


Në pajtim me nenin 10.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në kolegjin e ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit brenda njëzet e një (21) ditësh nga dorëzimi i këtij aktvendimi.

Kolegji i specializuar:

Hysen Gashi, Gjyqtar Kryesues,

Vladimir Kanev, Gjyqtar i EULEX,

Teuta Ibrahim, Gjyqtar,



Opinion mospajtues i anëtarit të kolegjit në lëndën C-V-15-0002

Nuk pajtohem me shumicën në lidhje me dhënien e 18 muajve të plotë në dispozicion në rrethanat aktuale. Pajtohem se pak është bërë në riorganizimin e Ndërmarrjeve Trepça dhe nuk ka ndonjë qartësim lidhur me zotimet në të ardhmen. Megjithatë, sipas mendimit tim, kjo situatë nuk është arsye për ta aprovuar zgjatjen maksimale. Duke pasur parasysh se "Ndërmarrjet Trepça" janë nën Moratorium që nga viti 2006 dhe se afati fillestar për dorëzimin e Planit zyrtarë të Riorganizimit ishte 9 muaj, çfarëdo zgjatjeje e mëtejshme e afatit duhet të konsiderohet me kujdesin më të madh dhe të aprovohet vetëm kundrejt një plani të qartë për realizimin e detyrave përkatëse. Një plan i tillë nuk ekziston dhe Agjencia nuk jep udhëzime për të ardhmen.

Në të vërtetë, aktualisht, Agjencia e Privatizimit është bllokuar nga skadimi i mandateve të të gjithë anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe mungesës së mjeteve financiare për të hapur tenderin për angazhimin e një Ofruesi të Shërbimeve Profesionale. Gjithashtu është e vërtetë, se këto probleme janë për shkak të institucioneve të tjera - Kuvendi i Kosovës nuk i ka emëruar anëtarët e Bordit dhe autoritetet financiare nuk kanë ofruar financime për nevoja të tilla. Këto institucione janë përtej fushëveprimit të procedurës për Riorganizim dhe kompetencës së Dhomës së Posaçme. Sidoqoftë, veprimet dhe lëshimet e tyre do të merren parasysh kur ato të ndikojnë drejtpërdrejt në aftësinë e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për të kryer detyrat e riorganizimit për "Ndërmarrjet Trepça". Kjo Agjenci duhet të jetë e plotësuar me staf dhe e mbështetur në vazhden e detyrave të saj.

Sipas pikëpamjes sime, vendimi më i përshtatshëm i gjykatës në këtë situatë do të ishte të pezullojë afatin për dorëzimin e Planit për Riorganizim deri sa Bordi i ri i Drejtorëve të AKP-së të bëhet efektiv. Kështu, koha që eventualisht do të kalonte nga shpallja e vendimit derisa Bordi të kompozohet, nuk do të llogaritej brenda periudhës 36 mujore të përcaktuar në nenin 2 të Ligjit 05/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-035. Prandaj, afati do të fillojë të rrjedhë përsëri vetëm kur Agjencia do të ketë aftësi të plotë administrative. Një qasje e tillë është ligjërish e paraqitur në nenin 42.3 të Ligjit Nr. 04/L-035 i cili i siguron gjykatës fleksibilitet maksimal në mbështetje të Agjencisë së Privatizimit dhe procedurës për Riorganizim. Procedurë e ngjashme është edhe në nenin 8.4 të Ligjit 04/L-035 mbi Riorganizimin e Ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurive të tyre. Në të vërtetë, kjo dispozitë është e dedikuar për situatën kur një person i ngarkuar me Riorganizim largohet nga detyra nga ana e gjykatës. Por çështja themelore është e njëjtë - mungesa e anëtarëve kyç të stafit, prandaj aplikimi në analogji është i pranueshëm.

Përndryshe, gjykata mund të zgjaste afatin me ca muaj, mjaftueshëm sa për emërimin e anëtarëve të Bordit të AKP-së dhe hapjen e një tenderi të ri për Ofrues të Shërbimeve Profesionale.

Zgjatja e afatit është një mjet i rëndësishëm për gjykatën për të kontrolluar rrjedhën e procedurës në Riorganizim dhe aprovimi i zgjatjes së plotë nën rrethanat e sqaruara më lartë mund të mos kontribuojë në ekzekutimin e procesit në kohë. Raportet tre-mujore munden që vetëm pjesërisht të sigurojnë kontroll substancial.

Dhe në fund - kushti që duhet të merret parasysh është se në mungesë të Komisionit të kreditorëve, kreditorët nuk mund të thonë fjalën e tyre në lidhje me zgjatjen e dhënë. Aprovimi i një zgjatje të shkurtër të afatit nuk do të ndikojë negativisht te Agjencia, sepse Agjencia mund të parashtrojë numër të pakufizuar të kërkesave për zgjatje të afatit brenda periudhës 36 mujore. Por periudha 18 mujore e aprovuar me aktvendim pa plane të qarta për angazhimet e ardhshme, mund të ndikojë të kreditorët të cilët kanë qenë në pritje që prej vitit 2006, që kërkesa e tyre të merret në konsideratë.